



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË


NYJA E PAZGJIDHUR

HAPAT DREJT SIGURISË DHE STABILITETIT NË VERI

Autor

Skender Perteshi

Hulumtues i Lartë



RRETH PREVENT

I themeluar në vitin 2024, Instituti për Siguri dhe Rezistencë - PREVENT synon një Kosovë ku siguria, stabiliteti dhe sundimi i ligjit ruhen përmes qasjeve inovative dhe bashkëpunuese. Duke promovuar reziliencën dhe gjithëpërfshirjen, PREVENT përpiqet të krijojë një shoqëri ku individët, komunitetet dhe institucionet punojnë së bashku për të trajtuar sfidat komplekse të sigurisë.

Misioni i PREVENT është të ndërtojë komunitete reziliente duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe ekspertizë në zhvillimin e politikave, avokim dhe zbatim të projekteve. PREVENT fokusohet në fuqizimin e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të rinjve, përmes hulumtimeve të bazuara në të dhëna, nismave për ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe duke luftuar aktivisht ekstremizmin e dhunshëm

Adresa: Prishtinë, Kosovë
E-mail: prevent.isr@gmail.com
perteshi.skender@gmail.com
Phone: +383 (0) 49 446 405
Website: www.prevent-ks.org

© Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme, mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen e shkruar të botuesit. Shfrytëzimi komercial i materialeve të botuara nga Instituti për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT nuk lejohet pa lejen e shkruar.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe Institutit për Siguri dhe Reziliencë-PREVENT dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo bashkëpunëtorëve.

Përmbajtja

1.Hyrje.....	2
2. Te gjeturat kryesore.....	4
3. Analizë përmbledhëse e sulmit terrorist në Banjskë.....	7
a. Forma e mbështetjes dhe trajnimet e grupeve terroriste nga Serbia.....	9
b. Një vit pas sulmit në Banjskë: çfarë thuhet në hetimet e institucioneve kosovare të drejtësisë	10
c. Sulmet terroriste në Veri pas takimit të Rashkës të mbajtur më 13 Tetor 2021.....	13
Sulmi terrorist serb në fshatin Banjskë.....	15
4. Sulmet terroriste në veri pas Banjskës: aktet terroriste në Zveçan dhe sulmi terrorist në Ibër-Lepenc.....	15
a. 26 nëntor 2024: Sulmi ndaj stacionit policor në Zveçan	15
b. 28 nëntor 2024: Sulmi ndaj Komunës së Zveçanit.....	16
c. 29 nëntor 2024: Sulmi terrorist ndaj infrastrukturës kritike në kanalin e Ibër-Lepencit.....	16
5. Potenciali i destabilizimit të situatës së sigurisë në Kosovë.....	20
a. Gjendja e sigurisë në Veri, pas intervenimeve për shtrirje të rendit dhe ligjit.....	23
b. Përpjekjet për forcimin e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës	25
c. Progresi në luftimin e krimit të organizuar dhe kontrabandës	25
6. Sfidat e sigurisë në pjesën veriore dhe rruga tutje?.....	26
a. Ndikimi i Faktorëve Ndërkombëtarë dhe Politik	26
7. Rekomandime.....	27

1. Hyrje

Ky raport synon të ofrojë një shqyrtim analitik të sulmeve terroriste në veriun e Kosovës dhe sfidat e institucioneve të Kosovës në shtrirjen e sovranitetit dhe autoritetit shtetëror në këtë pjesë që kishte mbetur jashtë kontrollit institucional të Kosovës që nga paslufta. Raporti vë në pah se pengesa kryesore në këtë drejtim është Serbia me veprimet dhe ndikimet e saj që pengon vazhdimisht, qoftë përmes kërcënimeve hibride ose formave tjera të drejtpërdrejta, çfarëdo përpjekje të shtetit të Kosovës për shtrirjen e sovranitetit dhe vendosjen e sundimit të ligjit në veri për të gjithë qytetarët pavarësisht se cilit komunitet i takojnë.

Pengesat më serioze deri më tash janë sulmet terroriste në veriun e Kosovës, gjegjësisht sulmi terrorist serb në fshatin Banjskë të Zveçanit më 24 shtator 2023 dhe sulmi tjetër i ndodhur në kanalin e ujësjiellësit të Ibër-Lepencit, në fshatin Varagë të Zubin-Potokut më 29 nëntor 2024. Këto sulme ishin paraprirë edhe nga një mori sulmesh të tjera kriminale e terroriste, ndonëse me intensitet më të vogël, kundër Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera shtetërore për të pamundësuar sundimin e ligjit në komunat veriore të Kosovës. Këtu përfshihet fushata e sponsorizuar nga Serbia dhe zbatuar nga subjekti politik Lista Serbe për bojkotimin e institucioneve të Kosovës punonjësve serb të institucioneve publike, gjegjësisht nga Policia, Prokuroria, Gjykata, dorëheqja e kryetarëve të komunave veriore, bojkotimi i zgjedhjeve komunale për zgjedhjen e kryetarëve të komunave veriore dhe kërcënimi i Listës Serbe, me përkrahje të plotë të Beogradit zyrtar, ndaj qytetarëve të komunitetit serb për të mos votuar në zgjedhje komunale dhe deri tek protestat e dhunshme më 2023 në komunat veriore ku ishin sulmuar pjesëtarë të Policisë së Kosovës, KFOR-i dhe mediat nga grupet kriminale serbe.

Lidhur me sulmin terrorist në Banjskë, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë më 11 shtator 2024 ndaj 45 personave të përfshirë në këtë sulm. Sulmi terrorist në Banjskë ishte udhëhequr nga nënkryetari i Listës Serbe, Milan Radojçiq, i akuzuar për disa vepra penale në Kosovë, i vënë në listën e sanksioneve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe, si dhe i shpallur në kërkim nga INTERPOL. Ai vazhdon të mbetet i lirë dhe i pandëshkuar në Serbi pavarësisht se ka pranuar publikisht që ka organizuar sulmin në Banjskë. Nga Prokuroria Speciale, Radojçiqi është i dyshuar për financim të terrorizmit dhe shpëlarje të parave, ndërsa në Banjskë ai me grupin e tij të armatosur terrorist ka pasur për qëllim që të shkapëtojë veriun e Kosovës dhe t'ia bashkëngjis atë Serbisë. Organizimi i sulmit terrorist në Banjskë, sipas aktakuzës së Prokurorisë, daton që nga viti 2021 gjatë një takimi në Rashkë të Serbisë të Radojçiqit me presidentin serb dhe strukturat më të larta shtetërore serbe.

Ndonëse veriu kishte nisur t'i kthehej rrjedhës normale gradualisht pas zbrapsjes së grupit terrorist serb të Radojçiqit nga Banjska dhe një vit pas këtij sulmi, situata e sigurisë do të merrte tatëpjetën drejt përkeqësimit gjatë muajit nëntor 2024 nga dy sulme terroriste në Zveçan (në stacionin policor dhe objektin e kësaj komune) për të arritur kulmin më sulmin terrorist në kanalin e Ibër-Lepencit në Zubin-Potok, ku kishte shpërthyer një eksploziv i rëndë me peshë deri 20 kilogramë.

Ky ishte sulmi më i madh terrorist ndaj infrastrukturës kritike në Kosovë që nga paslufta (1999) marrë parasysh rëndësinë e dyfishtë strategjike të këtij kanali për Kosovën: furnizimin me ujë të disa qyteteve të Kosovës përmes Liqenit të Ujmanit dhe rëndësinë për ftohjen e termocentraleve të Kosovës. Me këtë tentohet krijimi i një krize të rëndë për furnizim me ujë dhe të shkaktohet kaos energjetik në vend. Institucionet kosovare kishin reaguar me shpejtësi për të sanuar dëmet në Ibër-Lepenc, duke shmangur kështu një krize potenciale të furnizimit me ujë dhe rrymë. Qeveria e Kosovës ka bërë përgjegjëse Serbinë se ka orkestruar dhe dirigjuar këtë sulm përmes organizatave tashmë të shpallura terroriste nga Kosova që kanë vepruar në veri të vendit “Mbrotjtja Civile” dhe “Brigada Veriore”. Ky sulm terrorist ishte dënuar ashpër edhe nga bashkësia ndërkombëtare, kurse Beogradi zyrtar kishte mohuar përfshirjen në këtë rast. Për këtë rast, janë duke zhvilluar hetime organet e rendit dhe të drejtësisë në Kosovë, kurse janë identifikuar tashmë edhe personat e parë të dyshuar që kanë kryer këtë sulm terrorist në Ibër-Lepenc.

Raporti vlerëson se institucionet e Kosovës ende nuk kanë arritur të forcojnë dialogun social me serbët që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, për të adresuar shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë. Ai thekson se një bashkëpunim më i organizuar me komunitetin serb në këtë pjesë do të mundësonte uljen e mundësive për grupe kriminale dhe ekstremiste që operojnë në veri, duke parandaluar përhapjen e frikës dhe panikut në mesin e popullatës civile. Po ashtu, raporti vlerëson se Qeveria e Kosovës duhet të intensifikojë përpjekjet për zbatimin e projekteve të zhvillimit ekonomik në komunat veriore të Kosovës, për të forcuar integrimin e këtij komuniteti në jetën shoqërore dhe ekonomike të Kosovës.

Ky raport është hartuar kryesisht duke u bazuar në të hapura, dokuemnte zyrtare, deklaratat e liderëve politik në Kosovë e Serbi, si dhe raportime të mediave. gjatë periudhës 2022-2024 dhe nga dokumentet zyrtare të institucioneve të Kosovës lidhur me temën e trajtuar. Poashtu, raporti është bazuar edhe nga databaza e institutit PREVENT, i cili ka bërë mbledhjen e të dhënave të cilat lidhen me situatën e sigurisë në Kosovë me fokus në veriun e vendit.

2. Të gjeturat kryesore

Një vit pas sulmit terrorist serb në Banjskë

- Më shumë se një vit pas sulmit terrorist serb në fshatin Banjskë të Zveçanit, kreu i këtij grupi, Milan Radojçiq vazhdon të mbetet i pandëshkuar dhe i strehuar në Serbi pavarësisht se e ka pranuar se ka qenë organizatori i sulmit të armatosur terrorist në Banjskë. Beogradi zyrtar ka refuzuar të ekstradojë Radojçiqin në Kosovë për t'u dënuar lidhur me sulmin terrorist në Banjskë dhe vepra tjera penale që akuzohet se i ka kryer në Kosovë.
- Më 11 shtator 2024, Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzën për sulmin terrorist në Banjskë organizuar nga grupi terrorist serb në krye me Radojçiqin. Prokuroria ngri aktakuzë ndaj 45 personave për sulmin terrorist në Banjskë, përfshirë Radojçiqin. Ky i fundit gjendet në listën e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Britanisë së Madhe, ndërsa INTERPOL e ka shpallur si person në kërkim për sulmin terrorist në Banjskë.
- Aktakuza e Prokurorisë Speciale ngarkon grupin terrorist serb si të dyshuar për kryerjen e dy veprave penale: “Kryerja e veprës terroriste” dhe “Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës” të sanksionuara me Kodin Penal të Kosovës. Lidhur me Radojçiqin në mënyrë specifike, ai dyshohet se gjatë sulmit në Banjskë ka kryer dy vepra penale: “Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit” dhe “Shpëlarja e parave”.

Si ndodhi sulmi në Banjskë sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës?

- Sipas dosjes së aktakuzës, qëllimi i këtij grupi të armatosur terrorist në Banjskë ka qenë shpërndarja e veriut të Kosovës, respektivisht komunave të banuara me shumicë serbe dhe këtë pjesë të territorit t'ia bashkojnë Serbisë, ku si rezultat i dhunës së përdorur, ka vdekur zyrtari policor Afrim Bunjaku dhe është rrezikuar jeta e zyrtarëve të tjerë policorë dhe popullatës civile.
- Për më tepër, planifikimi i sulmit terrorist në veriun e Kosovës nga grupi i armatosur në krye me Radojçiqin, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale, është përgatitur dhe organizuar të paktën dy vite para se të ndodhi sulmi terrorist në Banjskë, nga muaji tetor i vitit 2021. Në aktakuzë përmendet një takim i mbajtur në Rashkë të Serbisë, më 13 tetor 2021, ndërmjet udhëheqësve të institucioneve më të larta shtetërore të Serbisë, ku i pranishëm ishte presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, me përfaqësues të strukturave ilegale të Serbisë që atë kohë vepronin në komunat veriore të Kosovës, përfshirë Milan Radojçiq dhe Vladimir Radivojeviq të cilët pranishëm në këtë takim. Në këtë takim, Radojçiqi dhe Radivojeviqi kishin kërkuar armatosjen dhe fillimin e rezistencës së armatosur kundër institucioneve të Republikës së Kosovës në katër komunat veriore. Pos kësaj, Radojçiq duke kërcënuar institucionet shtetërore të s

sigurisë në Kosovë, ishte shprehur “se herën tjetër do të mbrohem deri në fund, deri në vdekje”.

- Sipas Prokurorisë Speciale në Kosovë, deklaratimet e nënkryetarit të atëhershëm të Listës Serbe gjatë këtij takimi nënkuptojnë se ai ka pasur rolin kryesor në udhëheqjen e grupeve kriminale në veriun e Kosovës, ka qenë organizator i të gjitha ngjarjeve dhe incidenteve që kanë ndodhur në komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe konfirmon ose paralajmëron qëllimin për organizimet e ardhshme dhe rezistencën “deri në vdekje”, ku përfshihen sulmet të ndryshme në veri të vendit prej muajit dhjetor 2022 deri në sulmin terrorist në Banjskë më 24 shtator 2023. Aktakuza konstaton se këto sulme kanë qenë të organizuara “nga kreu i strukturave ilegale në veriun e Kosovës, i pandehuri Milan Radojçiq”.

Sulmet terroriste në Zveçan dhe në kanalin e ujësjellësit të Ibër-Lepencit në Zubin-Potok

- Edhe pse pas sulmit terrorist në Banjskë, veriu i vendit sërish u bë shënjestër e sulmeve terroriste. Në fund të muajit nëntor 2024, stacioni policor në Zveçan dhe ndërtesa e Komunës së Zveçanit ishin sulmuar me granata dore nga persona të panjohur, duke shkaktuar kryesisht dëme materiale. Këto sulme ishin cilësuar si “akte kriminale dhe terroriste” nga Qeveria e Kosovës. Për më tepër, për sulmin kundër stacionit policor në Zveçan, zyrtarë të lartë të Qeverisë kosovare ishin deklaruar se i dyshuar është Nemanja Radivojeviq, si person i afërt me Milan Radojçiqin.
- Një ditë pas sulmit në objektin e Komunës së Zveçanit, në veri të Kosovës, gjegjësisht në kanalin e Ibër-Lepencit i cili gjendet në fshatin Varagë të Zubin-Potokut do të ndodhte sulmi më i madh terrorist kundër infrastrukturës kritike të Kosovës që nga përfundimi i luftës më 1999. Ky kanal ishte cak i një sulmi të rëndë terrorist përmes shpërthimit të një eksplozivi i cili sipas Policisë së Kosovës ishte prej 15-20 kilogramë i aktivizuar me detonator mekanik përmes fitilit ndezës me djegie të ngadalshme. Kanali i Ibër-Lepencit ka rëndësi strategjike për Kosovën: furnizon me ujë disa qytete të Kosovës dhe shërben për ftohjen e termocentraleve të Korporatës Energjetike të Kosovës, ndërsa përmes këtij sulmi tentohej të krijohet një krizë e rëndë në Kosovë sa i përket furnizimit me ujë dhe energji elektrike.
- Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka akuzuar Serbinë për orkestrim të sulmit terrorist në kanalin e Ibër-Lepencit. Në komunikatën e publikuar nga Qeveria e Kosovës për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë thuhet se “ky sulm i radhës është orkestruar nga shteti serb, i cili ka kapacitete për një sulm të këtillë kriminal e terrorist. Elemente të organizatave terroriste “Mbrotja Civile” e “Brigada Veriore” dhe kryekrimineli Millan Radojçiq nën dirigjimin e Presidentit dhe Qeverisë së Serbisë planifikojnë e ushtrohen në Serbi për sulme të këtilla profesioniste”. Këshilli i Sigurisë ka miratuar masa shtesë për të forcuar sigurinë rreth objekteve dhe shërbimeve kritike në vend duke angazhuar në këtë drejtim Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

- Sulmi terrorist në Ibër-Lepenc ishte dënuar fuqishëm nga bashkësia ndërkombëtare. Bashkimi Evropian e kishte quajtur sulm terrorist dhe akti i neveritshëm sabotimi ndaj infrastrukturës civile të Kosovës. Kurse, ambasadori i SHBA-së në Kosovë, ndonëse kishte konstatuar se është ende herët të flitet për fajtorin ose të dihet se kush qëndron mbrapa sulmit në Ibër-Lepenc, megjithatë kishte thënë se “nuk mund të përjashtohet asnjë grup apo shtet”. Nga ana tjetër, Beogradi zyrtar kishte reaguar duke mohuar përgjegjësinë për sulmin terrorist në Ibër-Lepenc.
- Pas këtij sulmi terrorist, Policia e Kosovës gjatë bastisjeve në veri të Kosovës kishte gjetur armatim të rëndë dhe uniforma të ndryshme, më saktësisht ishin sekuestruar mbi 200 uniforma ushtarake, 6 raketa hedhës dore apo zolla, 3 granata dore, 2 armë AK47, 1 revole, municion të kalibrave të ndryshëm, pjesë të armëve, fitila ndezës për inicim të lëndëve plasëse, helmeta ushtarake, maska, thika, të holla në euro dhe dinarë dhe pajisje të tjera. Sipas Policisë, shumica e personave ndaj të cilëve janë kryer bastisje në pronat e tyre janë të dyshimtë në lidhje me organizatën “Mbrojtja Civile”. e shpallur terroriste nga Qeveria e Kosovës më 2023.
- Policia ka arrestuar disa persona të dyshimtë për këtë sulm terrorist, ndërsa për dy prej të arrestuarve Gjykata ka caktuar masë të paraburgim për një muaj. Sipas hetimeve të Prokurorisë Speciale, personi i dyshuar për sulmin në kanalin e Ibër-Lepencit është Jovan Viqentijeviq, i cili në bashkëkryerje me të dyshuarin tjetër, Dragisha Viqentijeviq, qëllimisht kanë dëmtuar pajisjet publike të ujësjellësit dhe kanë kryer veprën penale terroriste duke përdorur eksploziv dhe mjete eksplozive drejtpërdrejt në pjesën e kanalit dhe atë në infrastrukturën e betonit, duke aktivizuar eksplozivin në Ibër-Lepenc.
- Sipas të dhënave të Qeverisë së Kosovës dhe aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, anëtarët e “Mbrojtjes Civile” që morën pjesë në sulmin e armatosur në fshatin Banjskë në shtator të vitit 2022, kanë kontrata pune të drejtpërdrejta me strukturat shtetërore të Serbisë. Këta individë figurojnë në listën e pagave të Republikës së Serbisë dhe veprojnë nën udhëzimet e drejtpërdrejta të strukturave qeveritare serbe. Veprimet e tyre kanë ngritur shqetësime të thella për ndërhyrjen e Serbisë në çështjet e brendshme të Kosovës dhe për rolin që këto struktura po luajnë në destabilizimin e situatës në veri të vendit.

3. Analizë përmbledhëse e sulmit terrorist në Banjskë

Në shtator të vitit 2023, institucionet e Kosovës, përkatësisht Policia e Kosovës ishte përballur me sulmin më të rëndë terrorist kundër rendit juridik e kushtetues të Kosovës nga një grup i organizuar kriminal dhe terrorist serb në veriun e Kosovës. Ky sulm ishte udhëhequr nga politikani serb që vepronte në veriun e Kosovës, Milan Radojçiq, i akuzuar për disa vepra penale në Kosovë gjatë viteve të fundit nga organet e drejtësisë në Kosovë.¹ Sulmi terrorist kishte ndodhur në fshatin Banjskë të Zveçanit dhe gjatë kësaj kohe, Radojçiq ishte nënkryetar i Listës Serbe, formacion politik serb në Kosovë nën varësinë e drejtpërdrejtë të Beogradit për të kontrolluar komunitetin serb në Kosovë.²

Sulmi në Banjskë kishte ndodhur orët e hershme të mëngjesit, më 24 shtator 2023, me hyrjen e grupit terrorist serb në Kosovë nga Serbia përmes rrugëve malore ilegale në mënyrë të organizuar.³ Bazuar në informacione dhe dëshmi të grumbulluara nga Policia e Kosovës, grupi terrorist ishte trajnuar në poligonet e kazermave ushtarake në Serbi deri pak ditë para sulmit. Ata u nisën nga Novi Pazari i Serbisë në orët e mbrëmjes së 23 shtatorit 2023 dhe në orët e para të mëngjesit të 24 shtatorit kaluan në mënyrë të paligjshme kufirin mes Kosovës dhe Serbisë. Për kalimin e kufirit, ata përdorën një rrugë të paligjshme pranë pikës kufitare të quajtur “Izvor,” e cila është pika më e afërt me qytetin e Novi Pazarit në Serbi dhe fshatin Banjskë në komunën e Zveçanit. Pasi hynte në Kosovë, grupi terrorist u vendos në fshatin Banjskë, një lokacion strategjik që lidh komunat e Leposaviqit dhe Zveçanit me Mitrovicën e Veriut. Ky pozicion i zgjedhur për sulmin u mundësoi grupit qasje të shpejtë drejt objektivave të tyre dhe krijoi kushte për lidhje të shpejtë me forcat serbe të vendosura në territorin e Serbisë. Vendimi për këtë pozicionim dëshmon për një planifikim të detajuar dhe bashkëpunim të ngushtë me strukturat ushtarake serbe, duke ngritur shqetësime serioze për sigurinë dhe stabilitetin në rajon.

Ky grup terrorist kishin vendosur dy kamionë pa targa duke bllokuar rrugën tek ura e fshatit në Banjskë.⁴ Kjo ishte vërejtur nga Policia e Kosovës, e cila ishte duke patrulluar në atë pjesë të vendit. Në përpjekje për të liruar rrugën e bllokuar, Policia e Kosovës ishte sulmuar nga grupi i armatosur serb dhe si pasojë ishte vrarë në detyrë zyrtare rreshteri i Policisë, Afrim Bunjaku,⁵ ndërsa ishte plagosur një zyrtar tjetër policor dhe ishin lënduar tre policë të Policisë së Kosovës.⁶

Pas këtij sulmi në drejtim të Policisë së Kosovës, rreth 30 persona të armatosur rëndë dhe të maskuar nga grupi terrorist serb ishin larguar në drejtim të Manastirit të Banjskës për t'u fshehur në këtë objekt fetar nga i cili kishin sulmuar në vazhdimësi nga distanca Policinë e Kosovës.⁷

1. Koha Net. Radojçiqi pranon se e organizoi sulmin terrorist në Banjskë. 29 shtator 2023.

2. Kallxo. Millan Radojçiq mes ushtarëve e artilerisë ushtarake serbe. 26 tetor 2023.

3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. PPS.nr.75/2023, 11 shtator 2024, Aktakuzë për sulmin në Banjskë.

4. Po aty.

5. Po aty.

6. Koha Net. Vriten një polic i Kosovës dhe tre sulmues nga tensionet në veri. 24 shtator 2023.

7. Po aty.

8. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. PPS.nr.75/2023, 11 shtator 2024, Aktakuzë për sulmin në Banjskë.

9. Koha Net. Vriten një polic i Kosovës dhe tre sulmues nga tensionet në veri. 24 shtator 2023.

Tre nga sulmuesit e grupit terrorist serb ishin vrarë nga gjuajtjet me armë zjarri me Policinë e Kosovës¹⁰ dhe tre sulmues të tjerë të këtij grupi ishin arrestuar nga Policia.¹¹ Ky sulm terrorist kishte përfunduar në mesditën e datës 24 shtator 2023, kur shumica dërrmuese e grupit terrorist serb u arratisën në drejtim të Serbisë përmes rrugëve malore.¹²

Ky sulm terrorist ishte dënuar ashpër nga institucionet shtetërore të Kosovës, sipas të cilave Kosova ishte përballur me një formacion terrorist e kriminal profesionist që kishte planifikuar dhe përgatitur gjatë sulmin. Sipas kryeministrit kosovar, Albin Kurti, ky grup nuk paraqiste një bandë të kontrabandës, por strukturë mercenare, e përkrahur politikisht, financiarisht dhe me logjistikë nga Beogradi. Kryeministri Kurti ka konstatuar se Serbia dhe presidenti i saj, Aleksandër Vuçiq, qëndrojnë mbrapa sulmit të armatosur në Banjskë.¹³

Ndërkaq, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, në reagimin e saj kishte dënuar fuqishëm këtë sulm duke përkrahur Policinë e Kosovës, se ka legjitimitetin e plotë për vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë. Ambasada amerikane kishte bërë thirrje që autorët e këtij sulmi të sillen para drejtësisë. Pas Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, kishin reaguar edhe ambasada dhe misione të tjera ndërkombëtare kundër sulmit terrorist.¹⁴

Policia e Kosovës konfiskoi arsenalin e armëve, uniformave dhe pajisjeve logjistike që ishin gjetur në Banjskë dhe që i përkisnin këtij grupi të organizuar terrorist.¹⁵ Për më tepër, Policia e Kosovës kishte gjetur edhe dokumente të Milan Radojçiqit, që sipas institucioneve të Kosovës dëshmojnë se ai kishte qenë drejtpërdrejtë pjesëmarrës në këtë sulm.¹⁶ Krahas kësaj, pak ditë pas sulmit, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës publikoi video-incizime në të cilat shihej qartazi Radojçiq i armatosur në Manastirin e Banjskës bashkë me sulmuesit tjerë kur kishte ndodhur sulmi terrorist.¹⁷

Serbia ishin nën presion ndërkombëtar lidhur me sulmin terrorist serb në Banjskë nën udhëheqjen e Radojçiqit. Ky i fundit është i afërt politikisht me presidentin serb, Vuçiq, me të cilin është konsultuar e takuar vazhdimisht në Serbi lidhur me aktivitetet e Listës Serbe në Kosovë.¹⁸ Duke u përballur me dëshmitë dhe faktet e publikuara nga institucionet shtetërore të sigurisë në Kosovë, se nënkryetari i Listës Serbe kishte udhëhequr sulmin terrorist në veriun e Kosovës, Radojçiq publikisht pranoi se ka qenë organizatori i sulmit terrorist në Banjskë, përmes një deklarate të lexuar nga avokati i tij në Serbi më 29 shtator 2023.¹⁹ Përmes këtij deklarimi publik, avokati i tij njoftoi se Radojçiq ka dhënë “dorëheqje të parevokueshme” nga pozita e nënkryetarit të Listës Serbe, gjegjësisht dorëheqja e tij formale nga ky funksion erdhi disa ditë pasi kishte organizuar dhe udhëhequr sulmin terrorist në veriun e Kosovës.²⁰

10. Radio Evropa e Lirë. *Të arrestuarit në Banjskë, “shtetas të Serbisë”*. 25 shtator 2023.

11. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. PPS.nr.75/2023, 11 shtator 2024, Aktakuzë për sulmin në Banjskë.

12. Koha Net. *Videoja që tregon sulmuesit serbë duke ikur nga Manastiri i Banjskës*. 26 shtator 2023

13. Betimi për Drejtësi. *Një vit nga sulmi terrorist në Banjskë- Çka ndodhi ditën kur u vra rreshteri Afrim Bunjaku deri në ngritjen e aktakuzës?* 24 shtator 2024.

14. Ambasada e SHBA-së në Kosovë. *Deklarata e ambasadorit Jeffrey M. Hovenier*. 24 shtator 2023.

15. Koha Net. *Arsenali i armëve që u gjet në Banjskë, në fotografi*. 25 shtator 2023.

16. Telegrafi. *Çka përmban dokumenti i Radojçiqit, i cili u gjet gjatë aksionit në veri?*

17. Koha Net. *Sveçla publikon pamjet e Radojçiqit në Banjskë*. 26 shtator 2023.

18. Telegrafi. *Milan Radojçiqi në krah të Aleksandar Vuçiqit në takimin kërcënues ndaj Kosovës*.

19. Koha Net. *Radojçiqi pranon se e organizoi sulmin terrorist në Banjskë*. 29 shtator 2023.

20. Po aty.

Gjithashtu, në Serbi ishte organizuar një proces i shpejt gjyqësor ndaj Radojçiqit, fillimisht duke u arrestuar më 3 tetor 2023 nga policia serbe,²¹ por që u lirua një ditë më pas nga paraburgimi (4 tetor 2023). Prokuroria e Lartë Publike serbe kishte propozuar masë të paraburgimit, por kjo ishte refuzuar nga Gjykata e Lartë në Beograd. Gjykata serbe vetëm kishte caktuar masë që ndalon largimin e Radojçiqit nga Serbia pa miratimin e gjykatës, i ndaloj të shkojë në Kosovë, iu konfiskua përkohësisht pasaporta dhe u paralajmërua se mund t'i caktohet masa e paraburgimit nëse i shkel këto masa.²²

Ndërkaq, më pak se një vit pas sulmit të armatosur terrorist serb në Banjskë, më 11 shtator 2024, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë ndaj 45 personave për sulmin terrorist në Banjskë, përfshirë Milan Radojçiqin.²³

a. Forma e mbështetjes dhe trajnimet e grupeve terroriste nga Serbia

Serbia, përmes institucioneve të saj shtetërore dhe strukturave ilegale, ka mobilizuar dhe mbështetur grupe të armatosura me qëllim krijimin e tensioneve në katër komunat veriore të Kosovës. Këto struktura shtetërore serbe kanë udhëzuar dhe mbështetur individë dhe organizata si Mbrojtja Civile dhe Brigada e Veriut, me synimin për të destabilizuar Kosovën, veçanërisht në katër komunat e veriut të vendit. Ky veprim ka pasur qëllim të pengojë shtrirjen e rendit dhe ligjit në veri, duke krijuar mundësi për veprime destabilizuese. Aktivitete të tilla kanë përfshirë sulme të armatosura ndaj KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe popullatës civile. Serbia ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për strukturat kriminale dhe ekstremiste që veprojnë në territorin e Kosovës, duke kontribuar në ruajtjen e një klime të pasigurisë dhe tensioneve. Organizimi, mbështetja dhe sponsorizimi i grupeve terroriste nga Serbia janë realizuar në mënyra të shumta dhe të sofistikuara. Këto veprime kanë përfshirë:

- Planifikimin për krijimin e këtij grupi terrorist;
- Financimin e grupeve ekstremiste
- Ofrimin e trajnimeve për anëtarët e grupeve ekstremiste si Mbrojtja Civile
- Pajisjen dhe furnizimin me armë dhe municione luftarake, pjesa më e madhe e të cilave mund të gjenden vetëm në magazina ushtarake;
- Sigurimin e ndihmës logjistike dhe të inteligjencës;
- Sigurimin e mbështetjes për planifikimin ushtarak të operacioneve, të ndara në faza për pushtimin e veriut, të paraqitura në hartat ushtarake me detaje taktike dhe operacionale;
- Mbrojtjen dhe sigurimin e hapësirave (strehimeve), duke lejuar grupin të veprojë brenda territorit të Serbisë dhe në zonën kufitare me Kosovën, duke qenë uniformuar dhe të armatosur;

21. Telegrafi. Milan Radojçiq arrestohet në Serbi, i caktohet ndalim prej 48 orësh.

22. Zëri i Amerikës. Lirohet nga paraburgimi Milan Radojçiq, i ndalohej hyrja në Kosovë. 4 tetor 2023.

23. Radio Evropa e Lirë. Ngrihet aktakuzë ndaj 45 personave për sulmin në Banjskë - në mesin e tyre edhe Radojçiq. 11 shtator 2024.

Këto janë vetëm disa nga format e shumta të mbështetjes që Serbia ka ofruar dhe po ofron për grupet ekstremiste, të cilat kanë për qëllim destabilizimin e Kosovës, sidomos në pjesën veriore të vendit. Organizimi, mbështetja dhe sponsorizimi i grupeve terroriste nga Serbia janë realizuar në mënyra të shumta dhe të sofistikuar, duke përfshirë një gamë të gjerë veprimshmëri për të siguruar zhvillimin dhe fuqizimin e këtyre grupeve. Aktivitetet kanë përfshirë planifikimin dhe krijimin e grupeve të tilla, financimin e operacioneve të tyre, si dhe ofrimin e trajnimeve të nevojshme për rekrutët e rinj. Ky proces është mbështetur nga autoritetet dhe strukturat ushtarake dhe policore të Serbisë, të cilat kanë siguruar mjetet dhe mbështetje logjistike për operacionet terroriste, duke kontribuar në fuqizimin e këtyre grupeve.

Një nga mënyrat kryesore të mbështetjes ka qenë trajnimi i pjesëtarëve të grupeve në bazat ushtarake dhe stërvitore të Ushtrisë dhe Xhandarmërisë së Serbisë. Trajnimet kanë përfshirë përdorimin e armëve, manovra ushtarake dhe operacione të tjera që lidhen me veprime luftarake dhe taktika terroriste. Këto trajnime janë zhvilluar kryesisht në terrene stërvitore si ai i “Pasuljanske Livade”, ku grupet janë përgatitur për të përdorur armë të rënda, mjete shpërthyes dhe dronë. Po ashtu, grupet kanë zhvilluar stërvitje intensive në kompleksin ushtarak të Peshterit dhe në kazermën ushtarake të Rashkës, për të forcuar kapacitetet e tyre në terrenet malore dhe të vështira të Kosovës dhe Serbisë.

Pas shpalljes së organizatave “Mbrotja Civile”²⁴ dhe “Brigada e Veriut” si organizata terroriste nga institucionet e Republikës së Kosovës, shumica e anëtarëve të këtyre grupeve janë larguar në Serbi. Aty, ata kanë vazhduar stërvitjet intensive luftarake dhe ushtarake në bazat ushtarake të vendosura në Serbi. Një rol kyç në këtë proces ka pasur Milan Radojčić, i cili ka ofruar paga të larta për individët që pranonin të qëndronin pjesë e strukturave të “Mbrotjes Civile.” Kjo përpjekje synonte të forconte lidhjet dhe vazhdimësinë operacionale të këtyre organizatave, pavarësisht shpalljes së tyre si organizata terroriste nga autoritetet e Kosovës. Për më tepër, këta individë kanë intensifikuar përgatitjet luftarake me qëllim organizimin e sulmeve të mirëkoordinuara kundër institucioneve dhe rendit kushtetues të Kosovës.²⁵ Sipas të dhënave të Qeverisë së Kosovës dhe aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, anëtarët e “Mbrotjes Civile” që morën pjesë në sulmin e armatosur në fshatin Banjskë në shtator të vitit 2022, kanë kontrata pune të drejtpërdrejta me strukturat shtetërore të Serbisë. Këta individë figurojnë në listën e pagave të Republikës së Serbisë dhe veprojnë nën udhëzimet e drejtpërdrejta të strukturave qeveritare serbe. Veprimet e tyre kanë ngritur shqetësime të thella për ndërhyrjen e Serbisë në çështjet e brendshme të Kosovës dhe për rolin që këto struktura po luajnë në destabilizimin e situatës në veri të vendit.²⁶ Ky zhvillim përbën një sfidë serioze për sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës, duke nxitur nevojën për veprime të koordinuara ndërmjet institucioneve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë për të adresuar kërcënimet nga grupet e mbështetura nga struktura shtetërore të huaja.

b. Një vit pas sulmit në Banjskë: çfarë thuhet në hetimet e institucioneve kosovare të drejtësisë?

Vlen të konstatohet se organizatori i sulmit terrorist në Banjskë që nga viti 2021 gjendet në listën e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,²⁷ si dhe nga

24. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. PPS.nr.75/2023, 11 shtator 2024, Aktakuzë për sulmin në Banjskë.

25. Po aty.

26. Po aty.

27. Balkan Insight. US Imposes Sanctions on Controversial Kosovo Serb Businessman. 8 dhjetor 2021.

Britania e Madhe²⁸ më 2022 për korrupsion dhe krim të organizuar. Pos kësaj, në dhjetor të vitit 2023, mediat në Kosovë, duke cituar ministrin për Komunitete dhe Kthim të Qeverisë së Kosovës, Nenad Rashiq, njoftuan se Organizata Ndërkombëtare e Policisë, e njohur ndryshe si INTERPOL, ka lëshuar “njoftim të kuq”, përkatësisht e ka shpallur si person në kërkim Radojçiqin lidhur me sulmin terrorist në Banjaskë.²⁹

Ndërkaq, udhëheqësit e institucioneve të Kosovës deklarativisht kanë kërkuar disa herë ekstradimin e Radojçiqit në Kosovë,³⁰ por kjo është refuzuar nga Beogradi.³¹ Për më tepër, Kuvendi i Kosovës, përmes një rezolute të miratuar më 28 shtator 2023, mes tjerash, ka kërkuar “hetim ndërkombëtar ndaj Republikës së Serbisë lidhur me organizimin e aktiviteteve terroriste dhe vazhdimin e ekzistencës së kampeve stërvitore të grupeve terroriste në territorin e Serbisë”.³²

Aktakuza e Prokurorisë Speciale të Kosovës ngarkon grupin terrorist serb me dy vepra penale:³³

- Dyshimi i bazuar mirë se kanë kryer veprën penale, “Kryerja e veprës terroriste” e sanksionuar me nenin 129 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 128 par.1, pika 1.1, 1.3, 1.7 dhe 1.10 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës
- Dyshimi i bazuar mirë se kanë kryer veprën penale, “Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës” e sanksionuar me nenin 126 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 118 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Lidhur me Radojçiqin në mënyrë specifike, aktakuza për sulmin terrorist në Banjaskë, konstaton se ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer disa vepra penale:³⁴

- Ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale, “Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit” e sanksionuar me nenin 131 i Kodit nr.06/L-074 Penal Republikës Kosovës, lidhur me nenin 57 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
- Ekziston dyshimi i bazuar mirë se ka kryer veprën penale, “Shpëlarja e parave” e sanksionuar me nenin 302 i Kodit nr.06/L-074 Penal Republikës Kosovës, lidhur me nenin 56 par.1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Sipas hetimeve të bëra nga Prokuroria Speciale e Kosovës, qëllimi i këtij grupi të armatosur terrorist ka qenë “që të shkëpusin pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe dhe këtë pjesë të territorit t’ia bashkojnë Republikës së Serbisë, me ç’rast si rezultat i dhunës së përdorur, ka vdekur zyrtari policor Afrim Bunjaku dhe është rrezikuar jeta e zyrtarëve të tjerë policorë dhe popullatës civile”.³⁵

28. UK Government - Foreign, Commonwealth & Development Office. *UK sanctions target 30 corrupt political figures, human rights violators and perpetrators of conflict-related sexual violence around the world*. 9 dhjetor 2022.

29. Koha Net. *INTERPOL-i shpall në kërkim Radojçiqin*. 7 dhjetor 2023.

30. Radio Evropa e Lirë. *Sveçla: Do të kërkojmë ekstradimin e Radojçiqit dhe jo vetëm*. 29 shtator 2023.

31. Telegrafi. *Ripërserit Daçiq: Është i pamundur ekstradimi i Radojçiqit, Serbia nuk e njeh Kosovën*.

32. Radio Evropa e Lirë. *Kosova nxjerr rezolutë për hetimin ndërkombëtar të sulmeve në Banjaskë*. 28 shtator 2023.

33. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. PPS.nr.75/2023, 11 shtator 2024, Aktakuzë për sulmin në Banjaskë.

34. Po aty.

35. Po aty.

Aktakuza prej 158 faqesh ka vënë në pah se gjatë viteve 2017-2023, Radojçiqi, si kreu i grupit terrorist të strukturuar, ka qenë i përfshirë tërthorazi për të siguruar të ardhura dhe pjesa më e madhe e tyre janë përdorur për: armatim të rëndë (blerje dhe furnizim me armë të rënda për grupin terrorist), uniforma ushtarake (sigurimi i informatave për pjesëmarrësit e grupit) mbështetje logjistike (sigurimi i pajisjeve dhe shërbimeve logjistike për operacionet e grupit) dhe pagesën e pjesëmarrësve të grupit për financimin e pjesëmarrësve të grupit terrorist për të siguruar përfshirjen dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm në veprimtaritë kriminale në funksion të lehtësimit dhe financimit të veprave terroriste, gjegjësisht krijimit të kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e akteve terroriste.³⁶

Planifikimi i sulmit terrorist në veriun e Kosovës nga grupi i armatosur në krye me Radojçiqin, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale, është përgatitur dhe organizuar të paktën dy vite më herët, saktësisht daton që nga muaji tetor i vitit 2021. Dëshmitë e ofruara në aktakuzë janë në funksion për të nxjerrë në sipërfaqe se si ka nisur organizimi i këtij sulmi terrorist në veriun e Kosovës. Aty përmendet një takim i mbajtur në Rashkë të Serbisë, më 13 tetor 2021, ndërmjet udhëheqësve të institucioneve më të larta shtetërore të Serbisë, ku i pranishëm ishte presidenti serb, Vuçiq, me përfaqësues të strukturave ilegale të Serbisë që atë kohë vepronin në komunat veriore të Kosovës, përfshirë Milan Radojçiq dhe Vladimir Radivojeviq të cilët ishin të pranishëm në takim po ashtu.³⁷

Në këtë takim, Radojçiqi dhe Radivojeviqi “kërkojnë armatosjen dhe fillimin e rezistencës së armatosur kundër institucioneve të Republikës së Kosovës në katër komunat veriore si Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin-Potok”. Për më tepër, Radojçiq duke kërcënuar institucionet shtetërore të sigurisë në Kosovë, ishte shprehur “se herën tjetër do të mbrohem deri në fund, deri në vdekje”. Sipas Prokurorisë Speciale në Kosovë, deklaratimet e nënkryetarit të atëhershëm të Listës Serbe gjatë këtij takimi nënkuptojnë se ai ka pasur rolin kryesor në udhëheqjen e grupeve kriminale në veriun e Kosovës, ka qenë organizator i të gjitha ngjarjeve dhe incidenteve që kanë ndodhur në komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe konfirmon ose paralajmëron qëllimin për organizimet e ardhshme dhe rezistencën “deri në vdekje”. Në vazhden e kërcënimeve të tij kundër Kosovës, më 5 korrik 2022, Radojçiq paraqitet në një video-incizim nga Leposaviqi, duke deklaruar se “terrori i vërtetë ndaj popullit serb po fillon. Për popullin tim në veri dhe për të gjithë serbët, edhe të tjerët, me lejoni t’ju them se unë jam këtu, jam kthyer dhe ju e dini çfarë do të thotë sepse nga këtu nuk ka kthim mbrapa...”.³⁸

Dosja e Prokurorisë Speciale në lidhje me sulmin terrorist në Banjskë konstaton qartazi se pas këtyre paralajmërimeve dhe kërcënimeve deklarative kanë pasuar sulme të ndryshme në veriun e Kosovës prej muajit dhjetorit 2022 deri në ditën e sulmit terrorist më 24 shtator 2023 në Banjskë. Aktakuza përmend sulmet e shpeshta gjatë kësaj periudhe me armë zjarri kundër Policisë së Kosovës, Komisionit Komunal Zgjedhor dhe Komisionit Qendror Zgjedhor, sulme ndaj mediave dhe gazetarëve, vendosja e barrikadave dhe mjeteve eksplozive në barrikada, sulmet ndaj ushtarëve të KFOR-it, gjetje e armatimit në qershor 2023 i ngjashëm me armatimin e përdorur në sulmin e Banjskës dhe sulme të

36. Po aty.

37. Po aty.

38. Po aty.

tjera që arrijnë kulmin me sulmin terrorist dhe të armatosur kundër Policisë së Kosovës në Banjskë. Aktakuza konstaton se këto sulme kanë qenë të organizuara, siç thuhet, “nga kreu i strukturave ilegale në veriun e Kosovës, i pandehuri Milan Radojčić”.³⁹

Në seancës përgatitore për sulmin terrorist në Banjskë mbajtur më 9 tetor 2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dy prej të akuzuarve, Vlladimir Tolliq dhe Bllagoje Spasojeviq nuk kanë pranuar të deklarojnë për fajësinë e tyre, ndërsa i akuzuari tjetër, Dushan Maksimoviq, ishte deklaruar i pafajshëm. Këta tre të akuzuar ishin arrestuar nga Policia e Kosovës, ndërsa të akuzuarit tjerë janë në arrati.⁴⁰

c. Sulmet terroriste në Veri pas takimit të Rashkës të mbajtur më 13 Tetor 2021

Pas takimeve të mbajtura në Rashkë të Serbisë më 13 tetor 2021, lidhur me “rezistencën e armatosur” që duhej të organizohej kundër institucioneve të Kosovës për të penguar këto të fundit që të shtrijnë rendin dhe ligjin në komunat veriore të Kosovës, organizatat ekstremiste serbe rritën intensitetin e sulmeve të armatosura ndaj institucioneve të Kosovës, popullatës civile, Policisë së Kosovës, KFOR-it, EULEX-it, duke shkaktuar viktima mes civilëve dhe zyrtarëve policorë, plagosjen e shumë ushtarëve të KFOR-it, dëmtimin e pronës publike dhe private, si dhe duke penguar zhvillimin e jetës normale në pjesën veriore të Kosovës. Më poshtë mund të shihni një kronologji të sulmeve ekstremiste të armatosura, të organizuara nga Mbrojtja Civile dhe të udhëhequra nga Milan Radojčić.

- *Më 11 prill 2022*, në fshatin Zubç të Komunës së Zubin Potokut, Policia e Kosovës u sulmua me armë zjarri. Në këtë sulm nuk pati të lënduar apo dëme materiale të raportuara.⁴¹
- *Më 15 prill 2022*, një njësi patrulluese e Policisë së Kosovës në Zubin Potok u sulmua me bombë dore. Sulmet u kryen nga grupet ekstremiste dhe radikale në veri, me qëllim të pengimit të punës zyrtare të Policisë. Nga ky sulm nuk pati dëme materiale apo viktima.⁴²
- *Më 16 prill 2022*, dy shpërthime me bomba ndodhën afër patrullave të Policisë së Kosovës, më Leposavic. Sulmet u realizuan nga grupet ekstremiste dhe radikale në veri, me qëllim të pengimit të punës zyrtare të Policisë. Nga ky sulm nuk pati dëme materiale apo viktima.⁴³
- *Më 11 korrik 2022*, në përpjekje për të ndaluar kontrabandën në veri të vendit, 5 zyrtarë policorë të Policisë së Kosovës u plagosen në Zvecan, nga individë të grupit ekstremist radikal që operonin në veri të Kosovës.⁴⁴
- *Më 6 dhjetor 2022*, në ndërtesën e KKZ, së në veri të Kosovës, ndodhi një shpërthim me bombë. Ky sulm u krye nga pjesëtarë të grupeve ekstremiste aktive në veri, me qëllim të parandalimit të organizimit të zgjedhjeve të lira në këtë pjesë të vendit. Nga ky sulm u shkaktuan dëme materiale.⁴⁵

39. Po aty.

40. Koha Net. Tre serbët e arrestuar për sulmin terrorist në Banjskë nuk e pranojnë fajësinë. 9 tetor 2024.

41. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

42. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

43. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Prill 2022

44. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Korrik 2022

45. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

- *Më 9 dhjetor 2022*, në fshatin Serbovc të Komunës së Zveçanit, grupet ekstremiste sulmuan Policinë e Kosovës, duke plagosur një zyrtar policor. Sulmi kishte si qëllim pengimin e organizimit të zgjedhjeve lokale në atë pjesë të vendit.⁴⁶
- *Më 10 dhjetor 2022*, në veri të Kosovës, individë të lidhur me grupe ekstremiste si dhe me ato të krimit të organizuar vendosën barrikada në rrugët kryesore kombëtare që çonin në pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak. Kjo ndodhi pas arrestimit të Dejan Pantiq, me kombësi serbe, i akuzuar për organizimin e sulmit ndaj KKZ-së në veri të Kosovës. Bllokimet e rrugëve me mjete të rënda transporti e penguan lëvizjen e institucioneve të sigurisë në zonën e caktuar dhe të qytetarëve për rreth 20 ditë.⁴⁷
- *Më 11 dhjetor 2022*, një njësi e EULEX-it u sulmua në Rudarë, të komunës së Zveçanit me shok-bombë në veri të Kosovës nga grupet kriminale dhe ekstremiste aktive në këtë zonë. Sulmi kishte për qëllim të rrisë frikën dhe pasigurinë në këtë pjesë të shtetit.⁴⁸
- *Më 20 dhjetor 2022*, raportohet se në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicën e Veriut, ndodhi një shpërthim me bombë. Vendosja e bombës u realizua nga individë të grupeve ekstremiste në veri për të penguar organizimin e zgjedhjeve komunale. Nuk pati dëme apo viktima nga ky shpërthim. Nga ky sulm nuk u raportua për dëme materiale apo viktima.⁴⁹
- *Në datat 29-30 maj 2023*, u organizuan protesta të dhunshme në veri të Kosovës. Gjatë këtyre protestave, individë të përfshirë në grupe ekstremiste sulmuan ushtarët e KFOR-it me armë zjarri dhe mjete të tjera. Mbi 90 ushtarë të KFOR-it u lënduan rëndë dhe lehtë gjatë procesit të menaxhimit të protestave. Këto ishin njëra nga protestat më të dhunshme që kanë pësuar ushtarët e KFOR-it gjatë menaxhimit të turmave.⁵⁰

4. Sulmet terroriste në veri pas Banjskës: aktet terroriste në Zveçan dhe sulmi terrorist në Ibër-Lepenc

Edhe pse pas sulmit terrorist në Banjskë situata e sigurisë në veri të Kosovës dukej më e qetë dhe faktori i sigurisë ishte stabilizuar, veriu i vendit u bë sërish shënjestër e sulmeve terroriste. Kjo ndodhi për shkak të faktit se grupet ekstremiste nuk e pranuan humbjen e kontrollit në këtë pjesë të Kosovës dhe po tentonin të ndryshonin realitetin në veri përmes sulmeve ndaj aseteve kritike të shtetit. Ata synonin të frikësonin institucionet e vendit dhe të shtynin tërheqjen e forcave të sigurisë kosovare nga ky rajon. Në fund të muajit nëntor 2024, institucionet në Zveçan u sulmuan, ndërsa gjithashtu pati një sulm ndaj kanalit të Ibër-Lepencit përmes një eksplozivi në fshatin Varagë të Zubin-Potokut. Këto ngjarje bënë që veriu i Kosovës të kthehej sërish në vëmendjen e institucioneve kosovare të sigurisë, bashkësisë ndërkombëtare dhe mediave vendore e të huaja. Secili nga këto incidente trajtohet në vijim në formë kronologjike.

a. 26 nëntor 2024: Sulmi ndaj stacionit policor në Zveçan

Në orët e vona të mbrëmjes së 26 shtatorit 2024, sipas njoftimit zyrtar nga Policia e Kosovës, stacioni policor në Zveçan ishte sulmuar nga persona të panjohur të cilët kishin

46. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

47. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

48. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

49. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Dhjetor 2022

50. Të dhëna zyrtare publike të Policisë së Kosovës Maj 2023

hedhur dy granata dore në oborrin e stacionit policor. Si pasojë e këtij shpërthimi ishin shkaktuar dëme materiale, kurse Prokurori i Shtetit ka udhëzuar që rasti të iniciohet si “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”.⁵¹

Sipas zyrtarëve të lartë të Qeverisë së Kosovës, i dyshuari për sulmin ndaj stacionit policor në Zveçan është Nemanja Radivojeviq. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, kishte pohuar se Radivojeviq është “dora e djathtë” e Milan Radojçiqit.⁵²

b. 28 nëntor 2024: Sulmi ndaj Komunës së Zveçanit

Pak ditë pas sulmit kundër stacionit policor në Zveçan, një shpërthim tjetër kishte ndodhur në Zveçan, më saktësisht në ndërtesën e kësaj komune. Ngjashëm si me shpërthimin në stacionin policor, edhe ky sulm kishte ndodhur në orët e vona të datës 28 shtator 2024, ku një granat dore ishte hedhur në Komunën e Zveçanit. Nga ky sulm ishte dëmtuar objekti i komunës dhe katër vetura të qytetarëve serbë parkuara në afërsi të kësaj komune veriore. Sipas Policisë së Kosovës, dyshohet se shpërthimi ka ndodhur nga një granatë dore e llojit M-75 duke e cilësuar atë si “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm”.⁵³

Këto dy sulme në Zveçan ishin dënuar nga institucionet shtetërore të Kosovës. Qeveria e Kosovës i kishte cilësuar shpërthimet në Zveçan si “akte kriminale dhe terroriste”, si dhe sulme të tilla “në veri janë shprehje e dëshpërimit dhe qyqarllëkut të bandave kriminale me dirigjim nga Beogradi”.⁵⁴

Pas këtyre sulmeve, Policia e Kosovës kishte njoftuar se ka shtuar “masat e sigurisë në vend, përfshirë veriun e vendit ku ditëve të fundit kanë ndodhur disa sulme/incidente serioze kriminale”. Sipas Policisë, këto planifikime operative policore do të fokusohen në rritjen e prezencës policore në teren, duke realizuar më shumë patrullime në zona më kritike, më shumë pika kontrolli dhe rritje të bashkëpunimit me qytetarët. Për më tepër, përmes këtyre veprimeve, Policia kishte njoftuar se “do të ketë synim që të ruajë rendin e qetësinë publike, të parandalojë aktet kriminale e të hetojë e vejë para drejtësisë të gjitha ata që do të guxojnë të atakojnë sigurinë, ligjin dhe rendin kushtetues”.⁵⁵

Megjithatë, ende pa kaluar 24 orë nga sulmi ndaj ndërtesës së Komunës së Zveçanit dhe ndërmarrjes së këtyre veprimeve policore, kishte ndodhur sulmi më i madh terrorist ndaj infrastrukturës kritike në Kosovë që nga paslufta (1999), përkatësisht në kanalin e Ibër-Lepencit, në fshatin Varagë të Komunës së Zubin-Potokut,⁵⁶ që shqyrtohet si pjesë e veçantë në vijim.

c. 29 nëntor 2024: Sulmi terrorist ndaj infrastrukturës kritike në kanalin e Ibër-Lepencit

Kanali i ujit të Ibër-Lepencit i cili gjendet në Varagë, fshat në Komunën e Zubin-Potokut, ishte cak i një sulmi të rëndë terrorist më 29 nëntor 2024.⁵⁷ Ky kanal me peshë të

51. Radio Evropa e Lirë. *Stacioni policor në Zveçan sulmohet me dy granata dore*. 27 nëntor 2024.

52. Koha Net. *Bislimi: Krah i djathtë i Radojçiqit, i dyshuar për sulmin me granatë dore në Zveçan*. 30 nëntor 2024.

53. Koha Net. *Sulmohet me granatë dore ndërtesa e Komunës së Zveçanit*. 29 nëntor 2024.

54. Po aty.

55. Policia e Kosovës. *Rriten masat e sigurisë, për të garantuar rendin dhe sigurinë publike në shkallë vendi*. 29 nëntor 2024.

56. Koha Net. *Shpërthim në kanalin e Ibër-Lepencit në Zubin-Potok*. 29 nëntor 2024.

57. Po aty.

rëndësishme strategjike si pasuri e infrastrukturës kritike në Kosovë, përmes Liqenit të Ujmanit, furnizon me ujë disa qytete të Kosovës dhe shërben për ftohjen e termocentraleve të Korporatës Energjetike të Kosovës.⁵⁸ Sulmi i kryer në këtë kanal në fund të muajit nëntor 2024, sipas Policisë së Kosovës, është bërë përmes një eksplozivi me peshë deri në 20 kilogramë i vendosur në një çantë të zezë dhe ishte aktivizuar me detonator mekanik përmes fitilit ndezës me djegie të ngadalshme.⁵⁹ Pas shpërthimit të kanalit në Ibër-Lepenc, uji kishte filluar të rrjedhë në mënyrë të pakontrolluar dhe rrjedhimisht Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Mitrovica” kishte njoftuar se është ndërprerë furnizimi me ujë të pijshëm për shkak të dëmtimeve në kanal.⁶⁰ Në vendin e ngjarjes kishte dal menjëherë Policia e Kosovës dhe forca të misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR).⁶¹

Dëmtimet e shkaktuara nga shpërthimi në rrjetin e ujësjetllësit të Ibër-Lepencit ishin sanuar, megjithëse jo në tërësi, në një afat të shpejt kohor nga institucionet gjegjëse të Kosovës⁶² për të siguruar furnizim të rregullt me energji elektrike për vendin, në funksion të ftohjes së termocentraleve, si dhe për të evituar probleme të mundshme me ngrohje qendrore për qytetarët e Prishtinës. Ndërsa, furnizimi me ujë deri në riparimin e dëmit ishte kompensuar nga liqenet e Batllavës dhe Badovcit, si dhe përmes autoboteve.⁶³

Pas shpërthimit në Ibër-Lepenc, Këshilli i Sigurisë së Kosovës kishte mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme. Në komunikatën e publikuar nga Qeveria e Kosovës thuhet se “ky sulm i radhës është orkestruar nga shteti serb, i cili ka kapacitete për një sulm të këtillë kriminal e terrorist. Elemente të organizatave terroriste “Mbrotjtja Civile” e “Brigada Veriore” dhe kryekrimineli Millan Radoiqi nën dirigjimin e Presidentit dhe Qeverisë së Serbisë planifikojnë e ushtrohen në Serbi për sulme të këtilla profesioniste”. Në këtë mënyrë, ky sulm është cilësuar terrorist nga Qeveria e vendit dhe për këtë përgjegjës ka bërë drejtpërdrejt Serbisë si autore e sulmit kundër Kosovës, gjegjësisht infrastrukturës kritike të Kosovës. Pos kësaj, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka ndërlidhur sulmin terrorist në Ibër-Lepenc me sulme të ngjashme të Rusisë në Ukrainë ndaj kapaciteteve energjetike ukrainase në prag të dimrit. Në këtë mbledhje të Këshillit të Sigurisë ishin miratuar masa shtesë për të forcuar sigurinë rreth objekteve dhe shërbimeve kritike në vend, si ura, trafostacione, antena, liqene, kanale dhe objekte tjera duke angazhuar Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës për tu aktivizuar në terren për këtë qëllim.⁶⁴

Edhe bashkësia ndërkombëtare, përfshirë ambasadat e huaja në Kosovë, KFOR-i dhe Zyra e BE-së në Kosovë, kishin reaguar duke dënuar fuqishëm sulmin mbi infrastrukturën kritike të kanalit të Ibër-Lepencit dhe duke kërkuar hetime me qëllim të zbardhjes së detajeve të këtij sulmi kriminal dhe vënien para drejtësisë të autorëve të

58. Telegrafi. *Sulmi terrorist në kanalin e Ibër-Lepencit, sërish reduktime uji në Fushë Kosovë, Obiliq e Drenas.*

59. Telegrafi. *Drejtori i Policisë: Në sulmin e mbrëmshëm janë përdorur rreth 15 deri në 20 kilogramë eksploziv.*

60. Telegrafi. *Shpërthim i fuqishëm në Zubin Potok, dëmtohet kanali i ujit të Ibër-Lepencit.*

61. Kallxo. *Rritet prania e trupave të KFOR-it në veri.* 30 nëntor 2024.

62. Telegrafi. *Kurti: Në kohë rekord sanuam në masë të madhe dëmin e shkaktuar në Ibër Lepenc, çfarëdo sfide e tejkalojmë bashkë.*

63. Telegrafi. *Rizvanolli: Është siguruar furnizimi i rregullt me energji elektrike, Ibër Lepenci në afat rekord ka vendosur gjashtë tuba të përkohshëm.*

64. Zyra e Kryeministrit të Kosovës. *Këshilli i Sigurisë së Republikës së Kosovës mban mbledhje të jashtëzakonshme.* 30 nëntor 2024.

sulmit. Për më tepër, pos nga institucionet vendore, ky sulm ishte quajtur terrorist edhe nga Bashkim Evropian. “BE-ja e dënon ashpër sulmin terrorist të kryer të premtën në kanalin e ujit të Ibër-Lepencit në Zubin-Potok në veri të Kosovës. Është një akt i neveritshëm sabotimi në infrastrukturën kritike civile të Kosovës, që siguron ujë të pijshëm për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Kosovës dhe është një komponent jetik i sistemit energjetik të Kosovës”, thuhet në komunikatën e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri.⁶⁵ Ndërkaq, ambasadori i SHBA-së në Kosovë ka konstatuar se është ende herët të flitet për fajtorin ose të dihet se kush qëndron mbrapa sulmit në Ibër-Lepenc, por duke thënë se “nuk mund të përjashtohet asnjë grup apo shtet”. Ambasada e SHBA-së në Kosova ka kërkuar hetime të thukëta për të identifikuar përgjegjësitë dhe ngjashëm si BE-ja u ka ofruar ndihmë institucioneve të Kosovës.⁶⁶ Nga ana tjetër, Beogradi zyrtar kishte reaguar duke mohuar përgjegjësinë për sulmin terrorist në Ibër-Lepenc.⁶⁷

Një ditë pas sulmit terrorist në kanalin e Ibër-Lepencit, Policia e Kosovës kishte ndërmarrë veprime për ndriçimin e këtij rasti duke kryer dhjetë bastisje në veri të Kosovës. Në këto bastisje, Policia kishte gjetur armatim të rëndë dhe uniforma të ndryshme, më saktësisht ishin sekuestruar mbi 200 uniforma ushtarake, 6 raketa hedhës dore apo zolla, 3 granata dore, 2 armë AK47, 1 revole, municion të kalibrave të ndryshëm, pjesë të armëve, fitila ndezës për inicim të lëndëve plasëse, helmeta ushtarake, maska, thika, të holla në euro dhe dinarë dhe pajisje të tjera, si dhe në një rast të ndarë në Zveçan, forcat e rendit kishin gjetur sasi të konsiderueshme të armatimit. Sipas kreut të Policisë së Kosovës, shumica e personave ndaj të cilëve janë kryer bastisje në pronat e tyre janë të dyshimtë në lidhje me organizatën “Mbrotjtja Civile”, e cila ishte shpallur terroriste nga Qeveria e Kosovës më 2023, duke mos përjashtuar që rasti i Ibër-Lepencit të ketë lidhje edhe me Radojçiqin. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, shumica absolute e prodhimit të këtij armatimi ushtarak është serbe, e cila është vështirë të gjendet në tregun e zi.⁶⁸ Sipas kësaj ministrie, një pjesë e armatimit të gjetur nga Policia e Kosovës ka mbetur nga sulmi terrorist në Banjskë dhe pjesa tjetër është sjellë nga Serbia.⁶⁹

Përveç kontrolleve dhe bastisjeve në veri të vendit, Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale të Kosovës, ka shoqëruar dhjetë persona të dyshuar për rastin e Ibër-Lepencit. Sipas Prokurorisë Speciale, ata dyshohen për veprat penale të kryerjes së veprës terroriste dhe mbajtje në pronësi kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve. Dy prej personave të shoqëruar nga Policia me inicialet D.V. dhe D.M. nga komuniteti serb, me vendim të prokurorit janë ndaluar dhe ndaj D.V. është caktuar masa e paraburgimit për një muaj nga Gjykata, kurse i dyshuari tjetër D.M. është liruar në procedurë të rregullt. Kurse, më 1 dhjetor 2024, përmes vendimit të prokurorit, edhe i dyshuari J.V. nga komuniteti serb i kërkuar për këtë rast ishte ndaluar⁷⁰ ndaj të cilit Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar masën e paraburgimit prej 30 ditësh.⁷¹

65. European Union External Action – The Diplomatic Service of the European Union. *Kosovo: Statement by the High Representative on the water canal attack in Zubin Potok*. 30 nëntor 2024.

66. Radio Evropa e Lirë. *Hovenier për sulmin në Ibër-Lepenc: Herët të dihet fajtori, nuk mund të përjashtohet asnjë grup apo shtet*. 2 dhjetor 2024.

67. Radio Evropa e Lirë. *Vuçiq: Nuk kemi asnjë lidhje me atë që ndodhi në veri edhe Prishtina e di këtë*. 30 nëntor 2024.

68. Telegrafi. *Krejt çka u gjet gjatë bastisjeve në veri: Armë, zolla dhe mbi 200 uniforma ushtarake*

69. Indeksonline. *Sveçla për armatimin e kapur në Veri: Një pjesë e mbetur nga Banjska, një pjesë tjetër hyrje e re*. 30 nëntor 2024.

70. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. *Njoftim për media nga Prokuroria Speciale*. 2 dhjetor 2024.

71. Kallxo. *30 ditë paraburgim për Jovan Viqentijeviq, i dyshuar për sulmin terrorist në kanalin e ‘Ibër Lepencit’*. 3 dhjetor 2024.

Mediat në Kosovë kanë raportuar lidhur me dosjen e Prokurorisë Speciale të Kosovës që shpjegon se si ka ndodhur sulmi terrorist në Ibër-Lepenc. Në bazë të hetimeve nga Prokuroria, ekziston dyshimi i bazuar, se më 29 nëntor 2024, rreth orës 18:50, në pjesën e kanalit të Ibër-Lepencit, i dyshuari Jovan Viqentijeviq (i përmendur më lartë me inicialet J.V.) në bashkëkryerje me të dyshuarin Dragisha Viqentijevq (vëllain e tij, i përmendur më lartë me inicialet D.V.), me qëllim të shqetësimit serioz të banorëve dhe cenimit të rendit kushtetues dhe sigurisë publike në vend, qëllimisht kanë dëmtuar pajisjet publike të ujësjellësit dhe kanë kryer veprën penale terroriste duke përdorur eksploziv dhe mjete eksplozive drejtpërdrejt në pjesën e kanalit dhe atë në infrastrukturën e betonit. Në bazë të raportimeve mediale, Prokuroria konstaton se të dyshuarit e kanë aktivizuar eksplozivin dhe si pasojë kanë dëmtuar rëndë dhe e kanë bërë të papërdorshëm për shfrytëzim të mëtutjeshëm ujin, rrjedhimisht ua kanë pamundësuar qytetarëve furnizimin me ujë për pije dhe e kanë rrezikuar prodhimin e energjisë elektrike në nivel të vendit dhe me këtë kanë kryer veprën penale “Kryerja e veprës penale terroriste” nga neni 129, paragrafi 1 dhe neni 128 paragrafi 1.1 i lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës. Për më tepër, Prokuroria Speciale thotë se në shtëpinë e të pandehurit Jovan Viqentijeviq, në fshatin Prevlakë, gjatë kontrollit nga Policia e Kosovës janë gjetur dhe sekuestruar 3 granata dore BRM 75, 500 fishekë të kalibrit 7.9 mm, fishekë të ndryshëm të kalibrave të ndryshëm ende të panumëruar, dy thika për pushkë luftarake, dy karikatorë AK-47, një karikatorë për pushkë, mekanizëm për mbushjen e pushkës së gjuetisë MK-16, pushkë gjuetie, një thikë me këllëf, të cilën i pandehuri e mbante pa autorizim dhe pa leje nga organet kompetente, duke shkelur dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit për Armët. Me këtë, i dyshuari në fjalë dyshohet se ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366, paragrafi 2 dhe 1 të Kodit Penal. Hetimet për sulmin terrorist dhe shpërthimin në Ibër-Lepenc do të vazhdojnë tutje nga Prokuroria Speciale e Kosovës në bashkëpunim me organet e rendit.⁷²

5. Potenciali i destabilizimit të situatës së sigurisë në Kosovë

Pas fillimit të pushtimit ushtarak rus në Ukrainë më 2022, udhëheqësit e institucioneve të Kosovës kanë ngritur alarmin e rrezikimit të situatës së sigurisë dhe destabilizimit, veçanërisht të veriut të Kosovës nga Serbia me ndihmën e Rusisë. Krerët e shtetit, presidentja dhe kryeministri, përmes intervistave në mediat e huaja dhe paraqitjeve publike brenda e jashtë vendit, bënë thirrje për t'i bërë presion Serbisë për të mos provokuar situatën e sigurisë në Kosovës.

Serbia përdor formë të ndryshme të ndikimit tek komuniteti serb në veri të Kosovës. Ato përfshijnë elemente të luftës hibride (narrativi dezinformues kundër shtetit të Kosovës dhe institucioneve të sigurisë, shtrembërimi i gjendjes së komunitetit serb në Kosovë,

72. *Betimi për Drejtësi. Ekskluzive- Dosja e Prokurorisë: Vëllazërit Viqentijeviq dyshohen se kryen veprën terroriste duke përdorur eksploziv në kanalit e Ibër-Lepencit.* 3 dhjetor 2024.

73. CNN. *Kosovan President accuses Serbian leadership of orchestrating deadly shootout.* 3 tetor 2023

74. CNN. *Kosovo prime minister says he will not surrender country to Serbian 'fascist militia' after clashes in north.* 31 maj 2023.

lajme të rreme me përmbajtje të paverifikuar ose të pavërtetë etj.),⁷⁵ por edhe mënyra të tjera më të drejtpërdrejta, si barrikadat e vendosura nga strukturat ilegale serbe që operonin në rajonin verior të Kosovës,⁷⁶ bojkotimi i institucioneve të shtetit të Kosovës⁷⁷ nga radhët e komunitetit serb në Polici, Gjykata dhe Prokurori, dorëheqja e kryetarëve serbë të komunave veriore të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin-Potok), bojkotimi i zgjedhjeve për kryetarët e këtyre komunave veriore,⁷⁸ protestat e dhunshme në veri etj. Këto zhvillime në veri të vendit dhe bojkotimi i institucioneve të Kosovës nga ana e komunitetit serb ishte bërë nën diktatin dhe kërcënimet e Listës Serbe, nënkryetar i së cilës në atë kohë ishte Milan Radojčić, si dhe nën urdhrat e Beogradit zyrtar që ushtron kontroll të plotë politik mbi Listën Serbe.

Nga ana tjetër, refuzimi i Serbisë për të vënë sanksione ndaj Rusisë për luftën në Ukrainë, marrëdhëniet e mira mes Serbisë dhe Rusisë gjatë zhvillimit të luftës në Ukrainë, politika e balancuar serbe me Rusinë dhe Kinën në njërin anë, si dhe me Perëndimin, gjegjësisht Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në anën tjetër,⁸⁰ e ka vënë Serbinë në pozicion më të favorshëm rajonal në raport me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Politika e butë e vendeve perëndimore ndaj Serbisë, me synimin se politika e Beogradit zyrtar do të shkëputet nga Rusia dhe do të fokusohet në ndërtimin e raporteve të mira fqinjësore në funksion të integritetit në BE, nuk ka rezultuar e suksesshme, të paktën jo deri më tani. Pushteti në Serbi vazhdon të kultivojë raporte të afërta dhe miqësore me Moskën, jo vetëm marrëdhënie politike, por edhe ekonomike (përmes gazit rus njëra nga to) dhe kulturore (ndikimit fetar të religjionit ortodoks si emërues i përbashkët për të dyja vendet).⁸¹

Në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi të lehtësuar nga Bashkimi Evropian, pavarësisht gatishmërisë së institucioneve të Kosovës për të arritur marrëveshje me Serbinë, kjo e fundit vazhdon të mos i zbatojë marrëveshjet e dialogut dhe nuk ka treguar se është palë e interesuar për të qenë konstruktive në përmbjlljen e procesit të normalizimit të raporteve me Kosovën. Për më tepër, Kosovës i janë vënë masa kufizuese nga BE-ja, si pasojë e refuzimit të palës kosovare për të hartuar Statutin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe themelimin e këtij asociacioni sipas Marrëveshjes së Brukselit (shumica dërrmuese e neneve të kësaj marrëveshje nuk është në harmoni me Kushtetutën e Kosovës sipas aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës). Ndërkaq, përveç kritikave dhe vërejtjeve nga diplomatë të huaj dhe politikanë perëndimorë, Serbia nuk është sanksionuar dhe as nuk i janë vënë masa për sulmin e armatosur terrorist në Banjskë kundër Policisë së Kosovës, pavarësisht se ai ishte organizuar dhe përpunuar në Serbi kundër rendit juridik dhe kushtetues të Kosovës.

Edhe pas sulmit terrorist në Banjskë, Serbia ka vazhduar me provokimet e saj në dy drejtime:

1. Investime në armatim të avancuar ushtarak me blerje të pajisjeve ushtarake dhe duke armatosur ushtrinë e saj.
2. Kërcënime ushtarake duke dërguar ushtrinë serbe në afërsi të kufirit me Kosovën dhe

75. Hibrid.info. *Prapa ekraneve: Raport vjetor për gjendjen e çrregullimit informativ*. Korrik 2024.

76. Telegrafi. *Vučić: Heqja e barrikadave do të nisë mëngjesin e së enjtes*.

77. Kallxo. *Serbët bojkotojnë institucionet e Republikës së Kosovës, policët zhveshin uniformat – FOTO*. 5 nëntor 2022.

78. Radio Evropa e Lirë. *Lista Serbe bën thirrje për bojkotim të zgjedhjeve në veri*. 21 prill 2023.

79. Koha Net. *Protestuesit e dhunshëm plagosën 25 ushtarë të KFOR-it në Zveçan*. 30 maj 2023.

80. Radio Free Europe. *Vucic's Delicate Balancing Act*. 9 shtator 2024.

81. Associated Press. *Serbia's president thanks Putin for gas supplies and vows he'll never impose sanctions on Russia*. 20 tetor 2024.

me ndërmarrjen e ushtrimeve ushtarake në kufirin verior të Kosovës me Serbinë.

Për çështjen e armatosjes së ushtrisë serbe,⁸² edhe pse mund të thuhet se nuk ndërlidhet vetëm me Kosovën veçanërisht, por në kuadër të një militarizimi të Serbisë për të demonstruar fuqinë e vet rajonale në fushën e mbrojtjes ndaj fqinjëve të saj në Ballkanin Perëndimor dhe si pasojë e neutralitetit ushtarak në raport me NATO-n, megjithatë potenciali destabilizues nga ana e Serbisë ekziston. Ky militarizim i Serbisë vazhdon të shihet si kërcënim nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me theks të veçantë nga Kosova dhe Bosnja e Hercegovina të cilat nuk janë të anëtarësuara në NATO (në krahasim me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë që janë vende anëtare të NATO-s). Një ndërlidhje tjetër e këtyre investimeve ushtarake është edhe si pasojë e një “gare armatimi” mes Kroacisë dhe Serbisë për dominim në Ballkanin Perëndimor me qëllim të balancimit të fuqisë së Serbisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.⁸³

Para dhe pas sulmit në Banjskë, institucionet e Kosovës kanë vënë si prioritet kryesor vendosjen e sundimit të ligjit në veriun e Kosovës dhe kthimin e normalitetit pas një periudhe të gjatë të kontrabandës, kriminalitetit dhe krimit të organizuar në atë pjesë të vendit, e cila ishte nxitur dhe kontrolluar nga Serbia dhe grupet kriminale të lidhura me Serbinë për të mbajtur nën kontroll komunitetin serb përmes formave të ndryshme presionit dhe frikësimit. Rrugët e ndryshme ilegale që kishin shërbyer për zhvillim të kontrabandës nga grupe të ndryshme të krimit të organizuar janë mbyllur nga Policia e Kosovës,⁸⁴ ndërsa shume aksione policore të ndërmarra nga Policia në veriun e Kosovës në funksionit të rendit dhe ligjit kanë rezultuar pozitive në zvogëlimin e kriminalitetit në veri që ishte vatra kryesore e kontrabandës së mallrave të ndryshme që hynin nga Serbia në Kosovës përmes rrugëve ilegale ose edhe pikave kufitare derisa ato u vendosën nën kontrollin e institucioneve gjegjëse të Kosovës.

Pavarësisht këtyre lëvizjeve për normalizimin e situatës në veriun e Kosovës, Serbia ka bërë orvatje të ndryshme për të krijuar perceptimin se mund të krijojë dhe provokojë tensione në veriun e Kosovës edhe pas sulmit të grupit terrorist serb në Banjskë të Zveçanit. Hetimet që do të zhvillohen nga organet e rendit dhe të drejtësisë në Kosovë do të vërtetojnë nëse pas sulmit terrorist në Ibër-Lepenc qëndron Serbia. Ajo që dihet është se pas sulmit terrorist në Banjskë, Serbia kishte zhvendosur trupat ushtarake përgjatë kufirit me Kosovën⁸⁵ dhe për këtë kishte reaguuar Qeveria e Kosovës, duke kërkuar nga Serbia tërheqjen e trupave ushtarake nga vija kufitare me Kosovën, gjegjësisht në kufirin verior, verilindor dhe lindor. Sipas Qeverisë kosovare, Serbia vendosi kapacitetet ushtarake dhe të xhandarmërisë nëpër bazat e përparme operationale, që janë të shtrira përgjatë vijës kufitare me Kosovën, pak kilometra në thellësi të territorit të Serbisë.⁸⁶ Kjo zhvendosje e ushtrisë serbe në drejtim të kufirit me Kosovën kishte nxitur reagimin e bashkësisë ndërkombëtare. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e cilësuan si “zhvillim shumë destabilizues”, duke kërkuar nga Serbia tërheqjen e forcave nga kufiri me Kosovën.⁸⁷

82. Deutsche Welle. *What's behind Serbia's rearmament?* 11 korrik 2024.

83. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. *Çfarë është “Projekti 5000” i Serbisë dhe pse duhet të shqetësohemi?* Mars 2024.

84. Telegrafi. *Kontrabanda dhe krimi në veri, policia bllokoi rreth 20 rrugë ilegale në kufirin me Serbinë.*

85. Radio Evropa e Lirë. *Kosova i kërkon Serbisë t'i largojë trupat ushtarake nga kufiri me të.* 30 shtator 2023.

86. Koha Net. *Ushtria serbe lëviz nga tri drejtime për në kufi me Kosovën.* 30 shtator 2023.

87. Radio Evropa e Lirë. *Shtëpia e Bardhë: Dislokimi i ushtrisë serbe afër kufirit me Kosovën, shumë destabilizues.* 29 shtator 2023.

Edhe Bashkimi Evropian kishte kërkuar nga Beogradi ta ndalë sa më parë zhvendosjen e ushtrisë përgjatë kufirit me Kosovën dhe t'i tërheqë trupat e vendosura.⁸⁸ Pas këtyre reagimeve ndërkombëtare, Serbia kishte tërhequr forcat ushtarake nga kufiri me Kosovën.⁸⁹

Lidhur me bazat operationale të ushtrisë serbe përgjatë kufirit me Kosovën, ministri i Mbrojtjes i Qeverisë së Kosovës ka paralajmëruar se ato janë rrezik i përhershëm për Kosovë sepse në to janë të dislokuara tre nga katër brigadat e këmbësorisë serbe. Sipas tij, 48 bazat e ushtrisë serbe gjenden në një distancë të afërt me Kosovën nga 300 metra deri në 5 kilometra brenda kufirit të Serbisë dhe në kuadër të tyre janë rreth 4000 trupa ushtarake serbe, të pajisura me armatim dhe mjete për sulme ushtarake.⁹⁰

Edhe Komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), pas një takimi me kreun e AKI-së disa ditë pas sulmit terrorist në Banjskë, kishte alarmuar se Serbia është duke ndërtuar një bazë ushtarake në afërsi të kufirit me Kosovën, përkatësisht afër Izvorit në pjesën serbe.⁹¹

Në mars 2024, kryeministri i Kosovës kishte publikuar një video-incizim, duke deklaruar se “njësi të specializuara të ushtrisë së Serbisë janë vërejtur vetëm disa metra larg kufirit me Kosovën”, në afërsi të fshatit Banje të Zubin-Potokut. Sipas tij, institucionet e Kosovës po monitorojnë nëse forcat ushtarake serbe do të bëjnë përpjekje të kalojnë kufirin në drejtim të Kosovës, duke e cilësuar si provokim kundër Kosovës këtë stërvitje të ushtrisë serbe.⁹² Pas kësaj lëvizje të ushtrisë serbe në afërsi të kufirit me Kosovë, përfaqësuesit e misionit KFOR në Kosovë ishin deklaruar se situata në Kosovë është e qetë, por se ajo mbetet e brishtë.⁹³ Pas këtyre zhvillimeve kishte reaguar presidenti i Serbisë i cili ishte shprehur se “Serbia nuk do të futet në luftë, do ta presë momentin për veprim politik”.⁹⁴

a. Gjendja e sigurisë në Veri, pas intervenimeve për shtrirje të rendit dhe ligjit

Për shumë vite me radhë, veriu i Kosovës ka qenë një vatër e strukturave të krimit të organizuar dhe kontrabandës me armë, drogë, dhe aktivitete të tjera ilegale. Këto struktura kriminale nuk janë penguar asnjëherë, pavarësisht prezencës së mekanizmave ndërkombëtarë të sigurisë si UNMIK, EULEX dhe KFOR, për shkak të një qasjeje pragmatike të këtyre institucioneve që prioritzuan stabilitetin politik dhe ndër-etnik në vend, shpesh në dëm të sundimit të ligjit dhe sovranitetit të Kosovës.

Në këtë mjedis të paqëndrueshëm, strukturat kriminale kanë shfrytëzuar hapësirën që u është krijuar nga hezitimi i mekanizmave ndërkombëtarë dhe vendor për të ndërhyrë. Mbështetja e vazhdueshme dhe sistematike nga Beogradi zyrtar – përfshirë furnizimin me armë, financimin e operacioneve dhe trajnimin e anëtarëve të këtyre grupeve – ka ndihmuar në konsolidimin e këtyre strukturave.

88. Radio Evropa e Lirë. *Borrell i bën thirrje Serbisë ta tërheqë ushtrinë nga kufiri me Kosovën*. 30 shtator 2023.

89. Radio Evropa e Lirë. *Vërehet lëvizja e një kolone ushtarake në jug të Serbisë*. 30 shtator 2023.

90. Telegrafi. *Serbia 48 baza ushtarake në kufi me Kosovën, Maqedonci: Presin një moment të volitshëm për mësymje*.

91. Kallxo. *Pas takimit me drejtorin e AKI-së, Musliu: Serbia po ndërtonte një bazë të re ushtarake afër kufirit me Kosovën*. 2 tetor 2023.

92. Koha Net. *Kurti: Serbia provokon me ushtri afër kufirit me Kosovën*. 22 mars 2024.

93. Radio Evropa e Lirë. *Çfarë dihet për praninë e ushtrisë serbe pranë kufirit me Kosovën?* 22 mars 2024.

94. Po aty.

Ato janë shndërruar në rrjete të fuqishme, mirë të financuara dhe të armatosur ekstremiste e kriminale, të cilat jo vetëm që operojnë jashtë ligjit, por shpesh vendosin rregullat e tyre në atë pjesë të vendit. Kjo situatë ka penguar jo vetëm integritetin e veriut në strukturat shtetërore të Kosovës, por ka përbërë gjithashtu një rrezik të madh për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Periudha 2021-2023 ka shënuar një kthesë të rëndësishme në përpjekjet për shtrirjen e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës. Qeveria e Kosovës, nëpërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit si Policia e Kosovës, Prokuroria dhe institucionet tjera të sigurisë, të cilat kanë intensifikuar aktivitetet e tyre për të luftuar këto struktura kriminale. Operacionet e zbatimit të ligjit kanë synuar jo vetëm arrestimin e individëve të përfshirë në aktivitete kriminale e terroriste, por edhe adresimin e rrënjëve të këtij fenomeni, duke ndërprerë linjat e financimit dhe operacionet logjistike të këtyre grupeve.

Pavarësisht sfidave të shumta, përfshirë rezistencën aktive të grupeve kriminale dhe presionet politike e diplomatike, përpjekjet e institucioneve kosovare kanë filluar të japin rezultate konkrete që kanë minimizuar aktivitetet dhe prezencën e këtyre grupeve në atë pjesë të vendit. Shumë nga liderët e këtyre strukturave kriminale janë arrestuar ose ndodhen në arrati, kryesisht në Serbi, ndërsa rrjetet e tyre janë dobësuar ndjeshëm. Përveç goditjes së krimit të organizuar, është bërë progres edhe në forcimin e bashkëpunimit me komunitetet lokale, duke adresuar shqetësimet e ligjshme të qytetarëve serbë dhe të komuniteteve të tjera që jetojnë në veri të Kosovës.

Megjithatë, këto përpjekje mbeten ende të pamjaftueshme. Duhet të organizohen më shumë takime me komunitetin lokal, serb e tjerë, për të kuptuar më mirë shqetësimet e tyre për sigurinë dhe për të identifikuar intervenimet konkrete që duhet ndërmarrë për t'i adresuar këto shqetësime. Deri më tani, institucionet kosovare janë fokusuar kryesisht në shtrirjen e rendit dhe ligjit në veri, e cila është sfiduar vazhdimisht nga strukturat kriminale dhe ekstremiste. Megjithatë, aktivitetet që promovojnë dialogun social dhe bashkëpunimin me popullatën civile serbe, shqiptare, boshnjake dhe komunitetet tjera në atë pjesë, kanë qenë të kufizuara.

Kjo qasje duhet të ndryshojë. Qeveria e Kosovës duhet të fillojë zbatimin e projekteve zhvillimore, ekonomike dhe sociale në veri, si dhe të organizojë aktivitete dialoguese me komunitetin lokal. Këto përpjekje janë të nevojshme për dy arsye kryesore:

1. Rritja e pranisë institucionale dhe ndërtimi i besimit: Institucionet kosovare duhet të forcojnë praninë e tyre në veri, duke krijuar një ndjenjë sigurie dhe stabiliteti për popullatën civile, e cila për shumë vite ka jetuar nën presionin dhe frikën e strukturave kriminale dhe ekstremiste.
2. Forcimi i lidhjeve mes komunitetit dhe institucioneve shtetërore: Është e domosdoshme të ndërtohet dhe forcohet besimi i qytetarëve që jetojnë në veri ndaj institucioneve të Kosovës. Kjo mund të arrihet përmes dialogut të hapur, investimeve në projekte infrastrukturore dhe ekonomike, dhe garantimit të mbështetjes për të gjitha komunitetet, pa dallim etnie apo përkatësie tjetër.

b. Përpjekjet për forcimin e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës

Përpjekjet për të shtrirë rendin dhe ligjin në pjesën veriore të Kosovës kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e sigurisë për qytetarët serbë që jetojnë në atë zonë. Sipas të dhënave zyrtare nga institucionet e Kosovës, qytetarët serbë të veriut kanë filluar të kërkojnë më shumë përgjegjësi dhe shërbime të sigurta nga institucionet e Kosovës, në veçanti nga Policia e Kosovës.

Një indikator i rëndësishëm i këtij progresi është rritja e raportimit të rasteve kriminale nga qytetarët. Raste si vjedhjet në pronat private janë raportuar gjithnjë e më shumë, duke treguar besim në strukturat e sigurisë. Përveç kësaj, është vënë re një rritje e raportimeve për raste të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Policia e Kosovës ka reaguar në kohë ndaj këtyre rasteve, duke arrestuar individët përgjegjës dhe duke i dorëzuar ata përpara drejtësisë. Këto shembuj tregojnë një trend pozitiv ku qytetarët serbë dhe komunitetet e tjera që jetojnë në komunat veriore po bashkëpunojnë më shumë me institucionet e rendit, duke kontribuar në përmirësimin e sigurisë së përgjithshme.

c. Përpjekjet për forcimin e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës

Në vitet e fundit, janë shënuar arritje të mëdha në luftën kundër propagandës, krimit të organizuar dhe aktiviteteve ilegale si trafikimi i ilaçeve, karburanteve dhe narkotikëve në veri të Kosovës. Policia e Kosovës, përmes dhjetëra operacioneve policore, ka arritur të mbyllë laboratorë të ndryshëm të prodhimit të drogës dhe ka ndaluar grupe të përfshira në aktivitete të paligjshme.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm ka qenë ndalimi i aktiviteteve të paligjshme që lidhen me prodhimin e kriptovalutave, ku kompani të ndryshme që operonin në këtë fushë janë hetuar dhe mbyllur. Ky veprim ka ndihmuar në ndalimin e burimeve financiare që shpesh përdoren për të financuar veprimtari të paligjshme. Këto operacione janë vetëm disa nga shembujt ku është bërë progres i rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Në të njëjtën kohë, ato kanë kontribuar në forcimin e rendit dhe sigurisë, duke e integruar plotësisht veriun në kuadër të shtetit të Kosovës.

Megjithatë, puna nuk ka përfunduar. Situata në veri të Kosovës mbetet sfiduese dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Një ndër sfidat më të mëdha mbetet ndërtimi i besimit mes komuniteteve lokale dhe institucioneve të Kosovës. Për këtë arsye, përveç masave të zbatimit të ligjit, është e nevojshme që qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë të fokusohen në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore në këtë pjesë të vendit.

6. Sfidat e sigurisë në pjesën veriore dhe rruga tutje?

Muajt e ardhshëm pritet të sjellin një periudhë të tensionuar dhe të pasigurt për sigurinë e Kosovës, sidomos në veri, ku situata mund të përkeqësohet për shkak të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që do të ndikojnë në qeverisjen dhe rendin publik në këtë pjesë të vendit. Këto rreziqe kanë të bëjnë me një mori elementësh, duke filluar nga aktivitetet e grupeve kriminale e terroriste, ndikimi i aktorëve të jashtëm dhe mundësia e destabilizimit politik dhe institucional.

Grupet ekstremiste, duke u mbështetur në ideologji nacionaliste mund të përpiqen të shfrytëzojnë periudhën e ardhshme për të intensifikuar aktivitetet destabilizuese. Ata mund të realizojnë sulme të reja sabotuese që synojnë institucionet e Kosovës, veçanërisht ato që janë të angazhuara në forcimin e sundimit të ligjit në veri. Sulmet mund të jenë të natyrës fizike apo sulme të armatosura, siç janë sulmet ndaj objekteve të sigurisë dhe infrastrukturës kritike, por gjithashtu mund të shtrihen në fusha të tjera, si përhapja e propagandës përmes mediave sociale dhe aktiviteteve të tjera dezinformuese.

Kjo mund të dëmtojë mundësitë e Kosovës për të integruar plotësisht veriun dhe për të siguruar një kontroll të plotë të autoriteteve mbi këtë pjesë të territorit. Ndërhyrjet e tilla, përveç kërcënimeve fizike dhe ekonomike, mund të krijojnë një pasiguri të përgjithshme që do të minonte besimin e qytetarëve në shtet dhe do të rrisnin ndarjen ndërmjet grupeve etnike në rajon.

a. Ndikimi i Faktorëve Ndërkombëtarë dhe Politik

Një tjetër aspekt që pritet të ndikojë në situatën e sigurisë në veri është kalimi i administratës presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Deri në ndryshimin e administratës në SHBA, mund të krijohet një vakum në politikën ndërkombëtare amerikane ndaj Kosovës, duke i dhënë mundësi grupeve kriminale dhe ekstremiste të ndërmarrin veprime destabilizuese për të përfituar nga periudha e pasigurisë që mund të pasojë.

Një tjetër faktor që do të ndikojë në zhvillimet e sigurisë është periudha zgjedhore e ardhshme në Kosovë. Zgjedhjet parlamentare do të krijojnë një klimë të nxehtë politike, ku shumë institucione dhe aktorë politikë do të fokusohet në fushatat zgjedhore. Kjo mund të ndikojë në përqendrimin e resurseve dhe vëmendjes së autoriteteve kosovare në çështje politike dhe elektorale, duke krijuar mundësinë për rritje të aktiviteteve destabilizuese nga ana e grupeve kriminale dhe ekstremiste. Për shkak të këtij fokusimi, mund të rritet mundësia që ato grupe të shfrytëzojnë këtë periudhë për të intensifikuar operacionet e tyre destabilizuese dhe për të minuar autoritetin e institucioneve të sigurisë kosovare në Veri.

Për të adresuar sfidat dhe rreziqet e ardhshme në fushën e sigurisë me të cilat përballet vendi, sidomos në pjesën veriore të Kosovës, është e nevojshme që të vazhdojë koordinimi i ngushtë me partnerët ndërkombëtarë të sigurisë. Ky koordinim është thelbësor për ruajtjen e stabilitetit dhe përballimin e kërcënimeve që mund të rrezikojnë sigurinë e përgjithshme në vend. Partnerët kryesorë në këtë proces përfshijnë SHBA-në,

NATO-n dhe Bashkimin Evropian, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbështetje të institucioneve të Kosovës për të përballuar kërcënimet e brendshme dhe të jashtme.

Një nga elementët më të rëndësishëm për të siguruar stabilitetin është vazhdimi i bashkëpunimit të ngushtë me KFOR-in, i cili ka një rol kyç në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë. Ky koordinim do të ndihmojë në përmirësimin e reagimit të shpejtë ndaj kërcënimeve të mundshme, si dhe në rritjen e efikasitetit të operacioneve të sigurisë në terren. KFOR, si pjesë e mandatit të tij, ka për detyrë të sigurojë një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe rajonet më të ndjeshme si ato të veriut.

Për më tepër, fokusi i këtij koordinimi duhet të jetë në adresimin e rreziqeve që mund t'i kanosen aseteve kritike të shtetit, të cilat ndodhen në pjesën veriore të Kosovës. Këto asete përfshijnë infrastrukturën strategjike, lumenjtë dhe liqenet, asetet e telekomunikimit, objektet e sigurisë, si dhe burimet natyrore të rëndësishme. Rreziqet që vijnë nga këto aktivitete janë të shumta dhe përfshijnë sulme të mundshme ndaj këtyre aseteve, përpjekje për sabotim të infrastrukturës kritike, si dhe mundësinë e përhapjes së destabilitetit në rajon përmes operacioneve të organizatave kriminale ose ekstremiste.

Forcimi i dialogut social dhe zbatimi i projekteve zhvillimore për komunitetin është një tjetër aspekt që kërkon fokusin e Qeverisë së Kosovës. Qeveria duhet të hartojë plane konkrete për të ofruar një perspektivë të qartë ekonomike dhe të sigurisë për popullatën civile që jeton në veri, e cila, përveç sigurisë fizike, ka nevojë edhe për një përmirësim të kushteve ekonomike. Kjo do të përfshijë zhvillimin e projekteve që mundësojnë mundësi punësimi, investime në infrastrukturë dhe shërbime publike, si dhe mbështetje për sektorët e tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e komunitetit. Njëkohësisht, është e rëndësishme që këto projekte të përfshijnë dhe mbështesin bashkëpunimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe shoqërore që jetojnë në veri. Dialogu social dhe bashkëpunimi midis institucioneve, organizatave lokale dhe partnerëve ndërkombëtarë do të sigurojë një qasje të koordinuar dhe efektive në përballimin e sfidave që përballen ky rajon, duke i dhënë mundësinë popullsisë lokale të përfitojë nga mundësitë që ofron zhvillimi ekonomik.

7. REKOMANDIME

- Institucionet e sigurisë të zhvillojnë kapacitetet e mjaftueshme për parandalimin e sulmeve të mundshme terroriste në të ardhmen në Kosovë. Derisa veprimet policore pas sulmeve të tilla terroriste (Banjska dhe Ibër-Lepenci) kishin rezultuar të suksesshme, megjithatë institucionet shtetërore të Kosovës kishin dështuar në parandalimin e atyre sulmeve në veriun e Kosovës.
- Të ndërmerren masa shtesë të sigurisë për objektet e infrastrukturës kritike në rajonin verior të Kosovës për të shmangur sulme të ngjashme në të ardhmen nga grupe kriminale e terroriste, si dhe të vendosen kamera vëzhguese në këto objekte. Një koordinim, planifikim dhe bashkëpunim më i ngushtë me FSK-në, KFOR-in dhe EULEX-in është thelbësor në këtë drejtim.
- Të zhvillohen hetime të pavarura nga institucionet e drejtësisë në Kosovë në lidhje me sulmin terrorist në kanalin e ujësjellësit të Ibër-Lepencit.
- Misioni i NATO-s në Kosovë - KFOR të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës për kontroll më të rreptë të pikave kufitare të Kosovës me Serbinë për të ndaluar kontrabandën e armatimit në Kosovë nga ana e Serbisë.
- Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kërkojnë përgjegjësi nga Serbia lidhur me sulmin terrorist në Banjskë duke dorëzuar autorin e këtij sulmi, Milan Radojçiq dhe bashkëpunëtorët e tij tek institucionet kosovare të drejtësisë, si dhe të kërkohet llogari e të merren masa ndaj Serbisë për këtë sulm ndaj integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës. Në të njëjtën, Kosovës t'i hiqen masat kufizuese nga Bashkimi Evropian.
- Pala e Kosovës në dialogun me Serbinë të rimendojë se si do t'i qaset procesit të dialogut pas sulmeve terroriste në veri, veçanërisht pas zgjedhjeve presidenciale në SHBA dhe përfaqësuesve të rinj të zgjedhur në Bashkimin Evropian. Dialogu i lehtësuar deri më tash nga lehtësuesi Miroslav Lajçak ka qenë i pabarabartë dhe duke mos marrë parasysh ndryshimet e krijuara në terren.
- Përveç aspektit të sigurisë, institucionet kosovare, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, të zhvillojnë një qasje proaktive duke vendosur dialog të drejtpërdrejtë me komunitetin serb në komunat veriore të Kosovës për integrimin e këtij komuniteti në jetën publike dhe institucionale të Kosovës.
- Ndër prioritetet kyçe të Qeverisë së Kosovës në veriun e vendit duhet të jetë garantimi i një perspektive socio-ekonomike për veriun e Kosovës përmes një plani konkret dhe real për zhvillim ekonomik, qoftë përmes bizneseve të vogla e të mesme, subvencioneve të ndryshme dhe nxitjes së një stimulimi ekonomik në këtë rajon të vendit.



PREVENT

INSTITUTI PËR SIGURI DHE REZILIENCË